



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 8149 Prot

Vlorë, më: 27.05 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR MIRATIMIN E VENDQËNDRIMIT TË TAXIVE
DHE KRITERET PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI
NË BASHKINË VLORE

Data: 20.05.2024 ora 18.00
Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.119/2014 "Per të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Myzafer Elezaj-Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak, Zambak Selmani, Drejtor, Drejtorja e Infrastruktures dhe Investimeve Publike, Merita Mema, specialist, DIIP, përfaqësues nga grupi i interesit dhe media lokale.

Takimin e hapi Merita Mema, specialist pranë DIIP: Përshëndetje. Organizohet kjo dëgjese duke marrë shkas edhe nga kërkesa e sindikatës së taksive në Vlorë. Kemi 3 muaj, bashkëpunim me sindikatën, në zbatim të VKB Nr.68 datë 28.6.2018, ka lindur nevoja për rregullimin e numrit të taksive.

Sindikata e Pavarur e Taksive ka bërë kërkesë për shtimin e vendeve. Po ashtu dhe nga kërkesat e subjekteve fizike dhe juridike pas vitit 2018 e në vazhdim është rritur numri i mjeteve taksi 4+1. Me rritjen e numrit del dosmosdoshmëri dhe rishikimi i vendqëndrimeve përkatëse. Kemi qënë në terren me grupet e interesit, dhe kemi përcaktuar vendet e vendparkimeve me qëllim që të luftohet informaliteti, taksitë pirate, duke bërë dhe një shpërndarje sa me racionale të këtyre vendqëndrimeve, për tu shërbyer sa më mirë komunitetit dhe turistëve në qytet. Kemi sjellë ndryshime në numrin e vendeve dhe pozicioneve të vendparkimeve.

Vendndodhja	Nr.vend.
<u>Taksi 4+1</u>	
Rruga "Irfan Shehu"(në fillim të rrugës nga ana e lulishtes)	5
Rruga "Anita Bitri"(tek kapelja)	10
Sheshi para AlbTelecomit	6
Rruga"Janaq Kilica"(te Sh.H.Xhelo para stac.aut)	2
Rruga"Demokracia"(në fund të rrugës majtas)	4
Rruga "Demokracia"(mbas stacionit autb.interurb)	4
Xhamia (përbri sh.Nr.1,te stacioni urban)	6
Xhamia (para shkallëve të Kuzumbaba)	4
Bulevardi"Ismael Qemali"(Kali i trojes afër stacionit të autobuzit)	6
Bulevardi"Ismael Qemali"(përball lulishtesh te kali i Trojës)	6
Bulevardi "Ismael Qemali"(tek tre Racat, përball Kinoteatrit "Petro Marko")	4
Rruga "Kosova"(përball Rivierës)	4
Rruga"Kosova"(mbas stacionit të autobuzit përball Universitetit)	9
Në fund të Rrugës"Veledin Kollozi",tek kryqëzimi në krahun e djathtë)	3
Rruga "Hektor Shyti"(mbas Pallatit të Kulturës djathtas, te Porti)	3
Tek Rrapi (para stacionit të autobuzit urban)	5
Në fund të rrugës"Pelivan Leskaj",te kryqëzimi	3
Posta e Çoles (Rr.Zaho Koka, te kryqëzimi 3 vende majtas +3 vende djathtas, të spotuara)	6
Rruga "Mitaq Sallata"(përball Spitalit nga dera e parë)	4
Rruga "Gjergj Araniti"(te kryqëzimi me bulevardin Ismael Qemali, në të dy krahët nga 1 vend, mbas vijave të bardha)	2
Kala	2
Rruga"GjergjKastrioti"(kryqëzimi Tranballkanike me rrugën Enver Jaho", para rrethrotullimit)	5
Rruga "Gjergj Kastrioti"(në fund të rrugës Transballkanike kur vete te karburant Vola)	5
Rruga "Hasan Kushta" (te kryqëzimi me rr.Misto	2

Mela, mbas tabakinos)	
Sheshi Flamurit (afër Hotel Vlora, në fillim të lulishtes së vorezave)	2
Lungomare në krah të Hotel "Primavera"(mbas vijave të bardha)	2
Lungomare përball Bar Taushani(rruga lidhëse lungomare –unazë)	4
Lungomare në krah të Bar Hanover	3
Te rruga "Pilo Begaj", (përball trekëndëshit të kisha)	3
Kryqëzimi i rrugës "Rakip Malile" me rrugën "Dervish Hekali"	2
Në fund të rrugës "Gjergj Kastrioti"(në krah të djathtë afër Kastratit)	3
<u>Taksi 8+1</u>	
Tek trekëndëshi në hyrje të qytetit, në fillim	5
Njësia Administrative Orikum	
Bulevardi Princesha Rugjinë	6

Baza ato që kanë qënë. Ato vende që janë hequr janë shtuar diku tjetër. Këto janë me këskesat tuaja. Ishin 134 taksi me licencë janë shtuar 15 taksi. Janë gjithsej 185 vende. Vendet përballë ambulancës janë caktuar përballë Teatrit "Petro Marko".

Qytetar: Po te ndërhyrja në Lungomare? Duhet dhe atje.

Merita Mema. 5 vende janë.

Qytetar: Pse e hoqët nga ambulance?

Merita Mema: Është vend i dedikuar për ambulancat e shërbimit.

Zambak Selmani: Në qoftëse vendoset me këshill, si e mendon të vendosen para ambulancës?

Qytetar: Para loklait të ambulance, aty ku ka qënë gjithmonë. Duam aty.

Zambak Selmani: Te ambulance nuk bëhet, s'ka kuptim.

Qytetar: Janë 4 fishuar taksitë pirate. Duam vendet që na takojnë të punojmë. 23 vite pa tabelë kanë punuar. të vijë policia bashkiake ta zgjidhi.

Myzafer Elezaj: E kuptojmë shqetësimin. Raportoni te policia e shtetit pas miratimit në VKB, për zënien e vendit. Do ta zgjidhin ata.

Qytetar: Te ambulance duhet vendi i taksisë.

Myzafer Elezaj: KB ka detyrim të miratoj vendimin dhe të mbrojë interes tuaja. Keni të drejtë të mbroheni me strukturat e rendit. Jeni në detyrë, kërkoni nga policia e shtetit tju mbrojë. Sipas interesave të qytetarëve të ligjshëm, si taksapagues. Merrni policinë.

Qytetar: 15 mijë lekë taksimetër, nuk punohet me atë cmim. Duhet të ndryshoj.

Zambak Selmani: nuk rrisim dot cmimin e taksisë në këtë dëgjese. Të mbyllim këto që kemi sot. Të rregullojmë vendqëndrimet dhe numrin e taksive.

Qytetar: Te rruga Gjergj Araniti, si është pozicionuar vendi? Të jenë njëri pas tjetrit sipas vendeve të përcaktuara në vendim. Krijon konflikt. Kam 24 vite që punoj.

Zambak Selmani: s'ka qënë vendi i taksive aty. Është dakotësuar me taksixhiun që punon aty gjatë takimeve që kemi bërë. Ka dhe biznese aty. 3 biznese janë trotuar për parkim.

Qytetari: Jepja vendin para lokalit biznesit. Janë miratuar 3 vende dhe lamë një vend bosh për restorantin. Gjenero vendin. Jeni bërë pro biznesit.

Zambak Selmani: PV nuk duhet të çënoj edhe vendparkimet e bizneseve. Ka qënë me kërkesë të taksixhiut.

Myzafer Elezaj: Meqënëse qytetarët kanë pretendime, sygjeroj të gjendet zgjidhje për të dy palët. Pas takimit do të kërkoj Policisë Bashkiake të ruajë rendin për taksitë që të dinë vendet që kanë. Denonconi te Policia e Rendit kur ju zënë vendin pa të drejtë.

Qytetar: Duam vendet që duhen për të punuar. Vin Policia e Shtetit dhe na ndjek kur rrimë dyshe me të drejtë.

Qytetar: Policia bashkiake, nuk bën punë në këtë rast. Në Tiranë funksionon, në Vlorë jo, nuk na mbron.

Myzafer Elezaj: Drejtohuni te policia e shtetit kur ju zënë vendin. Do kërkohet zbatueshmëria nga Policia Bashkiake, kur të miratohet në VKB.

Qytetar: pozicion 5 vende, të vijë Policia Bashkiake dhe 2 vende për taksitë. Parkimi duhet zgjidhur, edhe unë biznes jamë paguaj taksa.

Myzafer Elezaj: Mbani shënime shqetësimet e qytetarëve.

Qytetar: Vihen gjopa dhe bëjnë punë.

Qytetar: ku do ankohemi. 11 makina nga TR marrin pasagjerë dhe ikin. Është shqetësim, kurse neve na gjobisin.

Merita Mema; Kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi. Viti 2018 kanë qënë 8 makina që licencoheshin. 2024 nuk diskutohet ndarjet e modeleve.

Duke qënë se numri i mjeteve taksi është i pakufizuar, kërkesat për licensim janë të larta, po ashtu kemi liberalizuar tipet e mjeteve, mendojmë se dhe viti i prodhimit të mjeteve që licensohen për herë të parë duhet të jetë i njëjtë për të gjitha tipet.

Taksi 4+1: -Për kompanitë e taksive(subjekte juridike) që licensohen për herë të parë, kërkohen mjete me vit prodhimi të njëjtë me vitin e licensimit (Km zero).Kompania e taksive duhet të ketë jo më pak se 5 mjete.

- Për subjektet fizike që licensohen për herë të parë viti i prodhimit, për të gjitha tipet e mjeteve të jetë jo më shumë 10 vjecare në momentin e licensimit.

-Mjetet taksi 4+1 që janë të licencuara nga bashkia dhe janë në aktivitet, do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet, ndërsa për mjetet që nuk e plotësojnë kushtin e mësipërm, do të rilicensohen me afat dy vjeçar, me të drejtë rinovimi të mjetit .

Mjetet taksi 8+1: .-Viti i prodhimit të mjeteve taksi 8+1 që do të licensohen për herë të parë të jetë jo më shumë se 10 vjet në momentin e licensimit, ndërsa për mjetet që janë të licencuara nga bashkia ,do të rilicensohen vetëm kur mosha e mjetit është jo më shumë se 15 vjet.

Makina të licencuara 2002-2003 rreth 16%

2004-2008 rreth 48 %.

Qytetar: Makina mbaron, si do veprojmë?

Merita Mema: 2023-2025 do rinovohen me afat 2 vjeçar. Ato në vazhdimësi me afat 15 vjeçar rinovimi.

Zambak Selmanaj: 15 vjet dhe 5 vjet shkon 20 vjet. Makina e 2015 dhe 15 vjeçar licenca.

Qytetar: Detyrim për licencim në vendin ku duhet. Jo në Himarë e pastaj në Vlorë të punoj. Hiqeni terminalin, cojeni ku duhet jashtë qytetit. Nuk ka vajtur ku duhet si në cdo qytet. Bëjeni si duhet. Taksixhiu duhet të jetë model. I certifikuar sipas standartit.

Myzafer Elezaj: Nga propozimet e sjella, një terminal për autobusat. Po diskutojmë me administratën për terminalin e bursave. Certifikata e gjuhëve të huaja, si akademia e cobanëve.

Zambak Selmani: Policia Bashkiak, sipas kërkesave tuaja është bërë rregullimi. Apo jo. E bëme së bashku!

Konceptoi: Albana Naçi



Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik